



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 24.1.2023

#### Dokument parlamentar

#### Komision përgjegjës

### R A P O R T

#### **PËR AKTIN NORMATIV NR.19, DATË 29.12.2022 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.115/2021 “PËR BUXHETIN E VITIT 2022”, TË NDRYSHUAR**

#### **I. Hyrje.**

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 24 janar 2023, shqyrtoi aktin normativ nr.19, datë 29.12.2022 “Për disa ndryshime në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar. Akti normativ u shqyrtua sipas rregullave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore, për këtë akt normativ, znj. Anila Denaj.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Adela Xhemali, Zëvendësministre;
- Z. Nikolla Lera, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Makroekonomike, Çështjeve Fiskale dhe Punësimit;
- Znj. Xhoana Agolli, Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;
- Znj. Sjuzi Lazebeu, Këshilltare.

#### **II. Baza ligjore.**

Akti normativ nr.19, datë 29.12.2022 është paraqitur për miratim nga Këshilli i Ministrave dhe shqyrtohet nga Kuvendi mbështetur në bazën kushtetuese e ligjore, si më poshtë:

- nenet 101 dhe 160 të Kushtetutës;
- nenin 46 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- rregullat e përcaktuara në kreun III të pjesës së dytë të Rregullores së Kuvendit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës, sipas kërkesave të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Miratimi i tij kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.

### **III. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.**

#### *III.1. Zhvillimet ekonomike gjatë vitit 2022.*

##### *Rritja ekonomike.*

Ekonomia e vendit, gjatë vitit 2022, vijoi zhvillimin me ritme pozitive. Pas rritjes së fortë të ekonomisë gjatë vitit 2021 prej 8.5 për qind, ritmi i rritjes gjatë vitit 2022 vazhdoi të jetë pozitiv, por me ritëm më të ulët, me një pritshmëri prej 3.7 për qind.

Nga pikëpamja e kërkesës, rritja ekonomike u ndikua nga rritja e konsumit dhe investimeve. Eksportet dhe importet u rritën ndjeshëm, por kontributi i tyre në rritjen e PBB ishte neutral.

Nga pikëpamja e ofertës, rritja e PBB u ndikua nga rritja e ndjeshme e sektorëve të ndërtimit dhe shërbimeve, si dhe rritja pozitive e sektorëve të bujqësisë dhe industrisë.

##### *Tregu i punës.*

Rritja ekonomike u shoqërua me përmirësim të treguesve të punësimit. Punësimi për vitin 2022 u rrit ndjeshëm, me 4.6 për qind. Norma e papunësisë vijoi tendencën rënëse, duke arritur nivelin 11.2 për qind në vitin 2022, nga 14.1 për qind që ishte në vitin 2017.

##### *Treguesit fiskalë.*

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit arritën nivelin 580 miliardë lekë. Këto të ardhura u realizuan në masën 96 për qind, me një mosrealizim prej 3.5 miliardë lekësh.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit arritën nivelin 645 miliardë lekë. Këto shpenzime u realizuan në masën 96.7 për qind, me një mosrealizim prej 21.9 miliardë lekësh.

Deficiti buxhetor u reduktua me - 3.5 miliardë lekë në krahasim me planin dhe - 19.8 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë. Ai arriti nivelin 3.2 për qind të PBB, nga 4.5 për qind e PBB që ishte një vit më parë.

Gjithashtu, vijoi reduktimi i deficitit primar fiskal, për të arritur drejt realizimit të objektivit të Kuadrit Makroekonomik e Fiskal Afatmesëm për kthimin e tij në nivel pozitiv në vitin 2023.

Borxhi publik vijoi tendencën rënëse, duke arritur nivelin 68.8 për qind të PBB, nga 73.2 për qind e PBB që ishte në vitin 2021 dhe 74.5 për qind e PBB në vitin 2020.

#### *Treguesit monetarë.*

Inflacioni i çmimeve të konsumit ishte në nivele të larta historike, duke arritur nivelin mesatar prej 6.7 për qind. Ndikimin kryesor e dha goditja e huaj. Megjithatë, përtej këtij efekti të drejtpërdrejtë, niveli i lartë i inflacionit vazhdon të ushqehet nga transmetimi i tij në koston e mallrave dhe shërbimeve, si dhe nga kërkesa relativisht e qëndrueshme për mallra e shërbime në vend, e cila siguron një shkallë të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve, veçanërisht në tregu e punës.

Normalizimi i politikës monetare synoi mbajtjen nën kontroll të inflacionit, duke synuar reduktimin e tij gjatë vitit 2023 dhe kthimin në objektiv në vitin 2024. Ky parashikim bazohet në reduktimin e pritur të inflacionit në ambientin botëror, në reduktimin progresiv të efekteve të raundit të dytë në vend, si dhe në ruajtjen e normave pozitive të rritjes ekonomike gjatë periudhës në vijim.

Sistemi financiar është i shëndoshë dhe efikas. Bankat shqiptare gëzojnë rezerva të mira kapitali, likuiditeti dhe norma të ulëta të kredive me probleme.

#### *III.2. Ndryshimet e mëparshme në buxhetin e vitit 2022.*

Buxheti i vitit 2022 është ndryshuar më parë me tri akte normative, si më poshtë:

- *Akti normativ nr.3, datë 12.3.2022*, i cili synonte akordimin e mbështetjes buxhetore për sektorin e energjisë elektrike dhe financimin e paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës. Ky akt normativ ruajti të pandryshuar treguesit kryesorë makroekonomikë, si deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Ai rriti të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit respektivisht me të njejtën vlerë, 10 miliardë lekë.

Paketa e rezistencës sociale u parashikua në vlerën 6 miliardë lekë dhe u shpërnda me vendim të Këshillit të Ministrave për zbutjen e efekteve të krizës aktuale, për të siguruar mbështetjen e shtresave në nevojë, sektorit të transportit publik dhe sektorit të bujqësisë.

Gjithashtu, ky akt normativ parashikoi disa rialokime në shpenzimet korrente e kapitale, për të rritur efektivitetin e tyre.

- *Akti normativ nr.12, datë 29.7.2022*, i cili parashikoi:
  - ✓ Rritjen e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit me 30 miliardë lekë, bazuar në rezultatet pozitive të mbledhjes së të ardhurave deri në atë periudhë;

- ✓ Rritjen e shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit me 13 miliardë lekë, me qëllim shtrirjen e mëtejshme të periudhës së financimit të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës, me vlerë 6.1 miliardë lekë;
  - ✓ Reduktimin e huamarrjes së brendshme dhe të deficitit buxhetor në masën 17 miliardë lekë, për të siguruar qëndrueshmërinë e parametrave makroekonomikë të vendit.
- *Akti normativ nr.17, datë 1.12.2022*, i cili bëri disa rialokime midis zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, duke reflektuar ecurinë e tyre për periudhën 11-mujore. Ky akt normativ rriti të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, respektivisht me 5 miliardë lekë, duke ruajtur të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik. Rialokimet midis zërave të shpenzimeve buxhetore synuan mbështetjen e disa projekteve priritare në fushat e ridërtimit, transportit rrugor, ujësjellës-kanalizimeve, zhvillimit ekonomik, infrastrukturës aeroportuale, gazifikimit të vendit, mirëmbajtjes rrugore, sistemit shëndetësor, digjitalizimit dhe qeverisjes elektronike, mbështetjes së fermerëve, infrastrukturës sportive etj.

### *III.3. Qëllimi dhe përmbajtja e aktit normativ.*

Akti normativ nr.19, datë 29.12.2022 parashikon ndryshimin e katërt në buxhetin e vitit 2022.

*Nevoja* për aktin normativ lindi pas analizës që Ministria e Financave dhe Ekonomisë i bëri realizimit të pritshëm të treguesve makroekonomikë e fiskalë, në fund të vitit 2022 dhe vlerësimit të kontributit që duhet të jepej për shpërndarjen e paketës së re të fundvitit, në formën e pagesave të menjëherhme, për një sërë kategorish të shtresave sociale.

*Qëllimi* i aktit normativ është dhënia e mbështetjes financiare të menjëhershme, në fund të vitit 2022, për disa kategori të shtresave sociale më në vështirësi, për të përballuar rritjen e inflacionit.

*Ndryshimet* që parashikohen në aktin normativ janë si më poshtë:

***Së pari***, rriten të ardhurat e përgjithshme të buxhetit me 1.5 miliardë lekë. Kjo rritje parashikohet në të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të cilat kanë pasur performancë të kënaqshme gjat vitit 2022.

***Së dyti***, rriten shpenzimet e përgjithshme të buxhetit në të njetjën vlerë, 1.5 miliardë lekë. Kjo rritje është rezultante e rialokimeve në shpenzimet buxhetore, si më poshtë:

- Rriten me 7.8 miliardë lekë shpenzimet për fondin rezervë të buxhetit të shtetit, në formën e mbështetjes financiare të menjëhershme për përballimin e inflacionit të luftës për disa kategori të shtresave sociale, e konkretisht:
  - ✓ 8 mijë lekë për çdo pensionisët;

- ✓ 8 mijë lekë për çdo përfitues të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar;
  - ✓ në masë të diferencuar për të gjithë punonjësit buxhetorë, përfshirë mjekët, infermierët, arsimtarët, punonjësit e Policisë, zjarrfikësit etj.
- Reduktohen shpenzimet korrente me 3 miliardë lekë, të detajuara si më poshtë:
- ✓ Shpenzime personeli 0.4 miliardë lekë;
  - ✓ Interesat 0.1 miliardë lekë;
  - ✓ Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes 0.9 miliardë lekë;
  - ✓ Subvencionet 0.08 miliardë lekë;
  - ✓ Shpenzimet për kompensimin në vlerë të pronarëve 1.5 miliardë lekë;
  - ✓ Shpenzimet për pagesën e papunësisë 0.03 miliardë lekë.
- Reduktohen shpenzimet kapitale me 2.6 miliardë lekë, të detajuara si më poshtë:
- ✓ Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm 0.6 miliardë lekë;
  - ✓ Shpenzimet kapitale me financim të huaj 2 miliardë lekë.

*Së treti*, deficitin buxhetor dhe borxhi publik nuk ndryshojnë.

#### **IV. Përputhshmëria e aktit normativ me kushtetutën.**

Akti normativ nr.19, datë 29.12.2022 plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 101 të kushtetutës, si dhe të analizuara në vendimin nr.24, datë 10.11.2006 dhe vendimin nr.23, datë 16.4.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

Nevoja për aktin normativ lindi për të siguruar financimin e një sërë shtresash të rëndësishme të popullsisë, me qëllim për t'i mbrojtur nga fenomeni i rritjes së çmimeve, i ndikuar nga situata gjeopolitike ndërkombëtare, sulmi Rus mbi Ukrainën.

Duke qenë se viti 2022 pothuajse kishte përfunduar, Këshilli i Ministrave vlerësoi se këto ndryshime ishin të nevojshme dhe urgjente, ndaj duhet të miratoheshin me akt normativ. Nëse ndryshimet buxhetore do të propozoheshin me projektligj, do të mungonte koha e nevojshme për sigurimin e mbështetjes financiare. Për këtë arsye, akti normativ plotëson edhe kriterin e urgjencës.

Gjithashtu, akti normativ plotëson edhe kriterin e përkohshmërisë, pasi vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë maksimale prej 45 ditësh, deri në datën e miratimit të tij nga Kuvendi. Ky akt normativ duhet të miratohet nga Kuvendi brenda datës 12 shkurt 2023.

## **V. Diskutimi në Komision.**

Zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë paraqiti aktin normativ, duke u ndalur në nevojën, synimet, përmbajtjen, si dhe impaktin e tij tek qytetarët dhe në ekonominë e vendit.

Relatorja theksoi se akti normativ është shumë i rëndësishëm, pasi mundësoi mbështetjen financiare të menjëhershme të disa kategorive të popullsisë, siç janë pensionistët, personat me ndihmë ekonomike dhe aftësi të kufizuar, punonjësit buxhetorë, përfshirë mjekët, infermierët, arsimtarët, punonjësit e Policisë së Shtetit dhe zjarrfikësit. Kjo mbështetje financiare u dha si masë lehtësuese për kompensimin e rritjes së inflacionit.

Mbështetja financiare u mundësua si nëpërmjet përdorimit të shtesës së të ardhurave, ashtu edhe reduktimit të shpenzimeve në zërat ku fondet buxhetore nuk janë përdorur tërësisht sipas planit.

Gjatë diskutimit, shumica e anëtarëve të Komisionit mbështetën mendimin e relatores dhe u shprehën pro miratimit të aktit normativ. Disa anëtarë të Komisionit kërkuan shpjegime dhe informacion më të plotë për nivelin e realizimit të treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë gjatë vitit 2022, siç janë të ardhurat, shpenzimet, deficitin buxhetor, borxhi publik etj, për të cilat përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhanë informacionet përkatëse. Gjithashtu, Zëvendësministrja e Financave dhe Ekonomisë dhe drejtuesit e tjerë të stafit teknik të kësaj ministrie dhanë informacionet respektive për çështjet e ngritura nga anëtarët e Komisionit, si më poshtë:

*Lidhur me pyetjen se për çfarë arsyesh ndryshimet e parashikuara në aktin normativ nr.19, datë 29.12.2022 nuk u parashikuan në ligjin fillestar të buxhetit apo në aktet e mëparshme ndryshuese të tij:*

Vendi ynë, prej 3-4 vjetësh, ndodhet në situatën e energjencave dhe të gjendjes së jashtëzakonshme, të ndikuar nga pandemia Covid-19, sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës, kriza energjitike dhe infacioni. Kjo situatë ka qenë me zhvillime dinamike, ndaj edhe shkalla e parashikueshmërisë, në fillim të vitit, nuk mund të ishte shumë e saktë. Për këtë arsye, buxheti i vitit 2022 është ndryshuar 4 herë (përfshirë aktin normativ nr.19, datë 29.12.2022), duke parashikuar paketa mbështetëse ndaj shtresave në nevojë dhe duke ndërmarrë masa të tjera në drejtim të zhvillimit ekonomik të vendit.

Në fund të vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë analizoi realizimin e treguesve makroekonomikë e fiskalë dhe evidentoi nevojën për përdorimin e shtesës së të ardhurave, si dhe të fondeve të papërdorura, për dhënie të mbështetjes financiare të menjëhershme për një sërë shtresash të popullsisë, të goditura më tepër nga rritja e inflacionit.

*Lidhur me faktorët që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave:*

Rreth 58 për qind e shtesës së të ardhurave është ndikuar nga rritja e inflacionit dhe reflektohet tek të ardhurat nga TVSH. Pjesa tjetër, prej rreth 42 për qind, është rrjedhojë e forcimit të miradministrimit fiskal dhe e rritjes ekonomike.

*Lidhur me marzhet e fitimit të kompanive të sektorit të karburanteve:*

Bordi i Transparencës në sektorin e karburanteve u ngrit për të bërë kontrollin e çmimeve, në situatën e rritjes së inflacionit, për të shmangur spekulimet e mundshme nga tregtarët dhe mbrojtur konsumatorin. Nëpërmjet këtij Bordi, u mbajtën nën kontroll fitimet e tregtarëve, duke synuar që çmimi final i konsumatorit të ishte sa më i ulët. Kjo masë bëri të mundur që marzhi i fitimit të sektorit të karburanteve, gjatë vitit 2022, të jetë ndjeshëm më i ulët në krahasim me atë të vitit të mëparshëm.

Gjatë muajit janar 2023 u evidentua një stabilitet i çmimit të karburanteve në bursat ndërkombëtare. Bordi i Transparencës për çmimin e karburanteve do të mbahet në fuqi për sa kohë që çmimet në këtë treg do të vijojnë të jenë ndjeshëm më të larta se mesatarja afatgjatë. Kur të ketë një reduktim të ndjeshëm të çmimit të karburanteve, Bordi i Transparencës do të dalë nga funksionimi.

Në përfundim të diskutimit, anëtarët e Komisionit theksuan se është e nevojshme që strukturat ekzekutive të përmirësojnë më tej procesin e planifikimit dhe zbatimit të buxhetit. Kujdes i shtuar nevojitet si në drejtim të rritjes së të ardhurave, ashtu dhe të monitorimit të kryerjes së shpenzimeve publike në përputhje me planin.

### **VIII. Përfundim.**

Duke qenë se akti normativ:

- Është në përputhje me kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- Ka ardhur dhe shqyrtohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit;
- Mundëson mbështetjen financiare të një pjese të rëndësishme të popullsisë kundrejt fenomenit të inflacionit;

Komisioni e miratoi aktin normativ nr.19, datë 29.12.2022 me shumicë votash.

**RELATORJA**

**Anila DENAJ**

**KRYETARI**

**Eduard SHALSI**